



P R O C E S V E R B A L I

Mbledhja e Komitetit për Komunitete e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më datë: **27.04.2026**, me fillim në orën **10:00**. Këtë mbledhje e kryesoi kryesuesja e komitetit, **Genta Morina**.

Kryesuesja: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! Faleminderit për kontributin dhe praninë tuaj. Përshëndetje për zëvendës kryesuesin, për shefin e ZKKK-së, për përfaqësuesit e KFOR-it, OSBE-së, për anëtarët e Komitetit për Komunitete dhe të për gjithë të pranishmit. Ky është takimi i **dytë** për vitin 2026. Për takimin e sotëm i kemi këto pika të rendit të ditës:

R E N D I T E

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës për vitin 2026;**
3. **Të ndryshme.**

Kryesuesja: Atëherë, ky është rendi i ditës për sot. Nëse dikush nuk ka diçka për të thënë, si të tillë po e vendosim! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë unanime aprovohet rendi i ditës.

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës për vitin 2026:**

Kryesuesja: Nëse dikush ka ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Në mënyrë unanime, miratohet pika e parë.

2. **Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës për vitin 2026:**

Kryesuesja: A ka dikush diçka, ndonjë propozim shtesë?.. Nëse jo, atëherë duhet të dini që në bashkëpunim me Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim e kemi përpiluar këtë draft që sipas mendimit tonë duhet të implementohet. Plani përbëhet kryesisht me vizita në vendbanime ku jetojnë komunitetet jo shumicë, takime me drejtorë, respektimi dhe përdorimi i gjuhëve zyrtare, zbatimi i strategjive të ndryshme. Plani gjithashtu shqyrton raportet e organeve komunale.

Skender Hamza: Përshëndetje për të gjithë! Si sekretari e kuvendit, mendojmë që plani duhet të përpilohet dhe të bëhet sa më preciz, sepse do të ishte më lehtë që të përpilohet rendi i ditës për mbledhjet e komitetit.

Lendrit Qeli: Faleminderit, kryesuese! Jemi munduar ta përshtasim këtë plan me planin e zyrës tonë, sepse Komiteti për Komunitete është mekanizëm me qëllim të njëjtë. Është i aplikueshëm, sepse të gjitha pikat që janë tani, kanë qenë edhe në planin e mandatit të kaluar, si dhe kanë pasur efekt. (Qendra për mësim nxënie në lagjen e epërme). Po e them këtë, sepse nuk kemi shumë kohë përpara, janë vetëm gjashtë muaj që ky plan duhet të implementohet nëpër 4 ose 5 mbledhjet e radhës, meqenëse ju do t'i mbani 6 të tilla.

Qazim Cana: Faleminderit! Përshëndetje për të gjithë! Ky plan është shumë i mirë. Plani i veprimit mund të ketë probleme vetëm nëse nuk e ka mbështetjen e drejtorëve. Drejtorët e drejtorive janë faktor kyç në zbatimin e dinamikës së planit, në infrastrukturë, arsim e shëndetësi.

Lendrit Qeli: Po, doktor! E thash që ky plan është në harmoni me planin e ZKKK-së.

Skender Hamza: Asnjëherë nuk e thash që plani është “i keq”, por do të ishte më mirë precizimi i pikave në plan dhe për thirrjen e mbledhjeve do të jetë lehtë për neve si zyrë, si dhe për kryesuesen e komitetit.

Ramë Berisha: Përshëndetje për udhëheqësinë. U fol për arsim e shëndetësi dhe unë ju bëj me dije që në komunën e Rahovecit ka shërbime publike dhe private, ku punojnë njerëzit e aftë. Në anën tjetër, kemi edhe njerëz me hendikep si dhe familje skamnore. E kemi shoqatën Hendikos ju sado pak u ndihmon, por e lus komunën që t'i del në ndihmë më shumë kësaj kategorie.

Vlora Vuçiterna – Çmega: Faleminderit, kryesuese! Mendoj që do të ishte më mirë që paraprakisht ta dimë se ku do të shkojmë në vizitë. P.sh. në mbledhjen e radhës mund t'i vizitojmë shkollat e caktuara.


3. Të ndryshme:

Ramë Berisha: Sa i përket materialit të komitetit, tani e kam hapur e-mailin dhe sekretaria e kuvendit mund të ma dërgojë në e-mail. Ju falënderoj.

Kryesuesja: Nëse edhe dikush nuk ka diçka tjetër, ju falënderoj të gjithëve për kontributin. Shihemi në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi: 10:30

Procesmbajtësi


Albion Krasniqi

Kryesuesja e mbledhjes


Gentë Morina

